
**THE ROLE OF THE NOTARY AS A TRUSTEE OF THE COURT IN INHERITANCE
PROCEDURE IN REPUBLIC OF MACEDONIA**

Fjolla Kaprolli
fjollakaprolli@gmail.com

Abstract: Although notary as an institution dates back to the earliest times, this institution and profession appeared in Republic of Macedonia very late. The appearance of this institution, which would provide a new way of realization and protection of human rights, in our country conditioned the process of democratization in which Republic of Macedonia was necessary to pass after its independence. Also, the interest of the Republic of Macedonia to participate in the European Union integration processes, made it unavoidable for this institution to fail to appear, because in the EU member states this institution was deeply rooted in every segment of life. As a result of this, various jurists and authors of the Republic of Macedonia for the formulating of the concept of notary as an institute, used different methods of comparison with the positive and negative experiences of a big number of European countries they could formulate a law of the "modern European" type like the first Law of notary in 1996. As states from whose experience the law has been drafted and at the same time the notary institution is also formed were: Italy, Germany, Austria, France, Slovenia, Croatia, Turkey, some US states, etc. Indeed, the first conditions that "opened the way" for the formation of the notary can be found in the issuance of the highest legal act - the 1991 Constitution of the Republic of Macedonia, according to which certain and important non-contentious matter can be solved in the form of public authorizations by the independent public service, and as result since 2008 with the issuance of the new law on uncontested procedure and the inheritance procedure as a non-contentious procedure that are lead by notaries as trustees of the court. The object of this research paper will be the legal analysis of inheritance procedure and of the role of notaries in the inheritance procedure. Through the analysis of regulations of the Law on non contentious procedure which regulates the inheritance procedure I will try to show the importance of the role of the notary as a trustee of the court in inheritance procedure.

Keywords: Law on non contentious procedure, inheritance procedure, notaries as trustee of the court.

**ROLI I NOTERIT SI I BESUAR I GJYKATËS NË PROCEDURËN PËR SHQYRTIMIN
E MASËS TRASHËGIMORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Fjolla Kaprolli
fjollakaprolli@gmail.com

Abstrakt: Edhe pse notariati si institucion daton që nga kohrat më të hershme, në R.M ky institucion dhe profesion u paraqit mjaft vonë. Paraqitjen e këtij institucioni i cili do të mundësonte edhe një mënyrë të re për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në shtetin tonë e kushtëzoi procesi i demokratizimit nëpër të cilën e kishte patjetër të kaloj R.M pas pavarimit të saj. Gjithashtu edhe interesimi i R.M- së për marjen pjesë në proceset integruese të Unionit Europian e bënte të pashmangshme mosparaqitjen e institucionit të tillë, pasi që në vendet anëtare të UE-së ky institucion ishte rrënjësor thellë me plotkuptimin e fjalës. Si rezultat i kësaj juristët dhe autorët e ndryshëm të R.M - së për formësimin e konceptit të notariatit si institut, përdorën metoda të ndryshme komperative me ç'rast nga përvojat pozitive dhe ato negative të një numri të madh të shteteve të Europës arritën që të formulojnë një ligj të tipit " modern europian " dhe atë Ligjin për kryerjen e punëve noteriele të vitit 1996. Si shtete nga përvoja e të cilave është përpiluar ligji dhe njëkohësisht është formësuar edhe institucioni i notariatit janë: Italia, Gjermania, Austria, Franca, Sllovenia, Kroacia, Turqia, disa shtete të SHBA - ve, etj. Realisht kushtet e para të cilët " e hapën rrugën " për formimin e notariatit mundemi t'i gjejmë në nxjerjen e aktit më të lartë juridik - Kushtetutën e R.M-së të vitit 1991, sipas të cilës punë të caktuara dhe të rëndësishme jokontestimore mundet të kryhen në formë të autorizimeve publike nga ana e shërbimit publik të pavarur, me këtë nga viti 2008 me nxjerjen e ligjit të ri për procedurë jokontestimore edhe procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore resp. procedura trashëgimore si procedurë jokontestimore e cila kryhet nga ana e noterëve si të besuar të gjykatës. Objekt i këtij punimi do të jetë analiza juridike e procedurës trashëgimore dhe të rolit të noterëve në procedurë. Nëpërmjet të analizës të normave të Ligjit për procedurë jokontestimore e cila edhe e rregullon procedurën trashëgimore, do të mundohem ta tregoj rëndësinë e rolit të notarit si i besuar i gjykatës në procedurë trashëgimore.

Fjalët kyçe: procedurë jokontestimore, procedura e shqyrtimit të masës trashëgimore, noterët si të besuar të gjykatës.

HYRJE

Trashëgimia paraqet një ndër institucionet më të vjetra të së drejtës civile. Rrënjët dhe shenjat e para të saj mundemi t'i gjejmë në paraqitjen e vet njerzimit, pra qysh në shoqëritë e para primitive edhe pse në forma më të ndryshme se kjo të cilën e kemi sot por me nivel të njejtë të rëndësisë. Them se ka të njejtën rëndësi nga shkakut se si në kohrat më të lashta ashtu edhe sot gjithmonë ka egzistuar trashëgimlënësi, trashëgimtarët dhe masa trashëgimore e trashëgimlënësit. " Pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, në shekuj brez pas brezi ka kaluar tek trashëgimtarët sipas bazave juridikisht valide për thirrje në trashëgimi."³⁷⁵

Në R.M procedura e shqyrtimit të masës trashëgimore është procedurë jokontestimore dhe si e tillë ajo rregullohet me Ligjit për procedurë jokontestimore të vitit 2008. Sipas Ligjit për procedurë jokontestimore ajo mundet të udhëhiqet nga ana e gjykatës apo nga ana e noterit si i besuar i tij. Sipas Ligjit për procedurë jokontestimore si dhe sipas literaturës juridike të vendit, si karakteristikë të procedurës trashëgimore është oficialiteti i saj, resp. nisja e ex officio e saj. Pra gjykata e nis procedurën trashëgimore sapo kupton për vdekjen e personit e cila në shumicën e rasteve bëhet në bazë të dorëzimit të aktvdekjes nga ana e ofiqarit kompetent. Në tekstin e mëposhtëm do të vërejmë një ndërthurje të veprimeve të organit i cili e udhëheq procedurën si dhe të personave tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë nga masa trashëgimore e të ndjerit.

1. NOTERËT SI TË BESUAR TË GJYKATËS NË PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË PASURISË TRASHËGIMORE

Sot notariati është e rregulluar me Ligjin për noterinë të nxjerur në vitin 2007 me të cilën notariati definohet si një shërbim i pavarur dhe publik, kryerja e punëve të të cilës është e rregulluar me ligj të cilat punë noteri i kryen në bazë të kërkesave të parashtruara si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga ana e organeve shtetërore apo të institucioneve tjera.³⁷⁶ "Ngarkimi i gjykatave me lëndë të cilët nuk janë kontestuese është i madh. "³⁷⁷ Kjo e ngadalson zgjedhjen e tyre si dhe të lëndëve tjera të karakterit kontestues. Pasi që proceset integruese përveç kërkesave dhe reformave tjera, kërkojnë edhe reforma në sferën gjyqësore e sidomos këmbëngulin në zgjedhjen sa më të shpejtë të lëndëve dhe sigurimin sa më të shpejtë të dhënies të mbrojtjes juridike subjekteve procedurale. Procesi i shkarkimit të gjykatave nga lëndët jokontestuese nuk ka tendenca të ndaloj. Ky proces ka filluar që nga viti 1996 me nxjerjen e ligjit të parë për noterinë dhe si e tillë vazhdon edhe sot. Definitivisht me nxjerjen e Ligjit të ri për procedurë jokontestimore në vitin 2008 u bë e mundshme kalimi i autorizimeve nga gjykata tek noterët si "te besuar të gjykatës " të cilët noterë bënin pjesë në rajonin e gjykatës e cila ia beson lëndën të njejtë.³⁷⁸ Me këtë rast u krijua edhe mundësia juridike e kalimit të lëndëve trashëgimore nga kryetari i gjykatës themelore tek noteri (neni 131). Me qëllim të rregullimit sa më të mirë të kësaj çështje, në Ligjin për procedurë jokontestimore të viti 2008 u përpilua një kre (kreu VIII) dhe atë nga neni 131 e deni në nenin 142. Para sjelljes të Ligjit për procedurë jokontestimore të vitit 2008 pasurinë trashëgimore e shqyrtonte gjykatësi i vetëm i Gjykatës themelore, pa mar parasysh se a egzistonte kontesti apo jo ndërmjet subjekteve procedural, apo lidhur me atë se kush janë trashëgimtarë, kontest për pronën e cila është pjesë e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit apo për pjesët që u takojnë trashëgimtarëve. Me Ligjin për procedurë jokontestimore të vitit 2008 u krijuan kushtet për dhënien e vendimeve kualitative dhe zgjedhjen më të shpejtë të lëndëve trashëgimore kontestuese në njërin anë dhe atyre jokontestuese në anën tjetër. Në këtë mënyrë përveç se në të ardhmen do të sigurohet zgjidhja më e shpejtë dhe më kualitative e lëndëve, gjithashtu do të zvogëlohet numri i lëndëve të pazgjedhura.

1.1 Procedura e udhëhequr nga noterët pas pranimit të lëndës
Gjykata themelore resp. kryetari i gjykatës trashëgimore pas pranimit të aktvdekjes të personit apo të vendimit të plotfuqishëm me të cilën personi i zhdukur shpallet i vdekur si dhe pas regjistrimit të lëndës në regjistrat e duhur gjyqësor, në afat prej 8 ditëve kryetari i gjykatës trashëgimore është i obliguar që t'ia dorëzoj lëndën për vendosje noterit kompetent i cili ka selinë në rajonin ku ndodhet gjykata e tillë. Noterët funksionin e tij dhe punët si të besuar të gjykatës i kryejn në përputhje me ligjet të cilët rregullojnë procedurat, kryerja e të cilave u është besuar t'i kryejn. Sipas kësaj noterët gjithmonë gjat shqyrtimit të pasurisë trashëgimore mbështeten në Ligjin për procedurë jokontestimore. Kryetari i gjykatës trashëgimore është i autorizuar që në përputhje me dispozitat juridike të Ligjit për procedurë jokontestimore, lëndët trashëgimore t'ua besoj për zgjidhje noterëve me seli në rajonin e gjykatës

³⁷⁵ Hamdi Podvorica, E drejta trashëgimore, Prishtine, 2006, fq. 5

³⁷⁶ neni 2 Ligji për noterinë

³⁷⁷ Јаневски, А, Потреба од растоварување на судовите од неспорни работи, Нотариус, бр.12, стр. 30

³⁷⁸ nenet 127 - 131 Ligji për procedurë jokontestimore

themelore kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.³⁷⁹ Janë disa rregulla të " lojës " të cilat noteri duhet t'i ndjek që të mundet që në mënyrë të plotgfuqishme t'a përfundoj procedurën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore. Rregulli themelor i cili është i paraparë edhe në Ligjin për procedurë jokontestimore (neni 132) dhe sipas të cilit noteri duhet që gjithmon të veproj është se të gjitha veprimet të cilat duhet t'i ndërmer noteri në procedurë si dhe vendimet të cilët ai duhet t'i sjellë në ato raste duhet të jenë në përputhje me ligjin resp. me Ligjin për procedurë jokontestimore. Detyra e parë e tij është *kontrolli i plotfuqishmërisë së aktvdekjes* e cila ka të bëjë me kontrollin e aktvdekjes si dokument publik në aspektin e kompletueshmërisë së saj, pra se a është aktvdekja e plotë apo jo. Në qoftë se aktvdekja i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme, noteri do të vazhdoj me procedurën. Por në shumicën e rasteve noterit i paraqiten aktvdekje jo te kompletuara, e në disa raste vetëm çertifikata të librit amzë të të vdekurve. Në këto raste noterit i ngel të veproj në dy mënyra: vet t'a komplettoj apo t'a përpiloj aktvdekjen nëse ka një të tillë apo kompletimin apo përpilimin e aktvdekjes t'ia besoj ofiqarit kompetent. Nga praktika e përditshme e noterëve, vërehet se në shumicën e rasteve ato vet e kompletjnë aktvdekjen jo të plotë apo e përpilojnë një të tillë në rastë të mungesës së saj me qëllim të vazhdimin sa më të shpejtë të procedurës. Kompletimin e një aktvdekje apo përpilimin e tillë të njejtës, noteri e bën në bazë të të dhënave të fituara nga ana e familiarëve dhe të afërmeve të të vdekurit. Në këto raste noteri gjithmon duhet të jetë i kujdesshëm në atë se të dhënat a janë apo nuk janë të sakta si dhe identike me të dhënat e dokumenteve të paraqitura bashkë me aktvdekjen, " duke i mar si relevante dhe të besueshme të dhënat për të vdekurin nga libri amzë i të vdekurve ".³⁸⁰

Gjat përpilimit të aktvdekjes, në raste të kërkesës të parashtruar nga ana e trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave tjerë të cilët kanë ndonjë interes nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, si detyrë e ardhshme e noterëve mundet të paraqitet kryerja e *regjistrimit dhe i vlersimit të pasurisë trashëgimore*. Në nenin 141 të Ligjit për procedurë jokontestimore është paraparë që objekt regjistrimi të jetë e gjithë prona e të ndjerit të cilën e ka poseduar deri në momentin e vdekjes së tij, prona e cila i ka takuar të ndjerit por e cila gjendet te ndonjë person tjetër, me ç'rast gjat regjistrimit theksohet se cila pronë te cili person gjendet në momentin e vdekjes të trashëgimlënësit dhe mbi cilën bazë. " Në regjistrim veçanërisht shënohen kërkesat edhe obligimet e të ndjerit dhe në veçanti tatimet e papaguara dhe dhënit tjera ".³⁸¹ Kur regjistrimin dhe vlersimin e bën noteri, të dhënat nga regjistrimi dhe vlersimi i tillë, noteri është i obliguar që t'ia dorëzoj gjykatës trashëgimore.³⁸²

Hap tjetër gjithashtu i rëndësishëm është edhe *kontrolla e kompetencës vendore* të gjykatës trashëgimore nga ana e noterit. Gjat kontrollit të kompetencës vendore të gjykatës trashëgimore, noteri gjithmon mer parasysh dhe mbështetet në nenin 129 e cila ka të bëjë me vendbanimin resp. vendqëndrimin e trashëgimlënësit në momentin e vdekjes së tij apo të vendit në të cilën trashëgimlënësi ka pasurinë e tij të tundshme apo të patundshme. Si veprim tjetër mjafti rëndësishëm i cili ndërmiret nga ana e noterit në procedurën shqyrtimit të pasurisë trashëgimore dhe të cilat korenspondojnë me " parimin e socialitetit " si një ndër parimet më të rëndësishme të procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore është *mbrojtja e veçantë e cila u jepet personave të veçantë* në procedurë. Në grupin e personave të veçantë bëjnë pjesë personat e mitur të cilat nuk mundet që të kujdesen për të drejtat e tyre të cilat të drejtat dalin nga pasuria trashëgimore, personi i cili nuk ka prindër si dhe në qoftë se pritet lindja e një fëmije i cili do të mundet të thuret si trashëgimtar (neni 164). Në këto raste noteri duhet të njoftoj Qendrën për punë sociale i cili në afat prej 30 ditëve duhet të caktoj kujdestar i cili do të mbroj të drejtat e këtyre personave të cilët kanë nevoj për një mbrojtje të tillë. Nëse Qendra për punë sociale nuk cakton brenda periudhës 30 ditore kujdestar për fëmijë të palindur, atëherë për të do të kujdeset njëri nga prindërit i cili duhet t'i ndërmer të gjitha veprimet me të cilat do të arrihet mbrojtja e të drejtave dhe interesave të fëmijës të palindur. E njejtja vlen edhe atëherë kur Qendra për punë sociale mer pjesë në procedurë kur duhet të mbrohen të drejtat dhe interesat e personit të mitur pa prindër. Paimi i socialitetit korenspondon edhe me situatën e dytë, resp. me veprimin tjetër të noterit e cila ka të bëjë me " nevojën e ndërmarrjes të masave për sigurimin e pasurisë trashëgimore "³⁸³ nga ana e noterit. Ky veprim procedural i ndërmarrur nga ana e noterit ka për qëllim që të mbrohen interesat e trashëgimtarëve në rastet kur ai nuk është i aftë që të udhëheq me pronën dhe njëkohësisht kur trashëgimtari nuk ka përfaqësues ligjor, si dhe

³⁷⁹ neni 131 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁸⁰ Стоеб, Фиданчо, Положба и овластувања на нотарот како повереник на судот во оставинската постапка, Нотариус, бр. 11, стр. 13

³⁸¹ Јаневски.А, Зороска - Камилоска. Т, Граѓанско процесно право - Вонпарнично право, Скопје, 2010, стр. 142

³⁸² neni 151 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁸³ Стоев, Фиданчо, Положба и овластувања на нотарот како повереник на судот во оставинската постапка, Нотариус, бр. 11, стр. 13

në rastet kur trashëgimtarët mungojnë apo nuk dihen se kush janë.³⁸⁴ Qëllim tjetër i shqiptimit të masave të tilla është ikja e çfarëdo lloji të kontestit i cili mund të paraqitet ndërmjet subjekteve procedurale, me ç'rast noteri gjithmonë apo vetëm një pjesë të saj i'a dorëzon për ruajtje personit të tij të besuar.

1.2 Seanca për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Sipas nenit 167 të LPJ - së, noteri atëherë kur e konsideron të nevojshme apo kur atë e kërkon njëri nga personat të thirrur në trashëgimi (trashëgimtarët, legatët, apo persona të tretë), do të " caktoj seancë "³⁸⁵. Seanca e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore gjithmonë fillon me " ftesë "³⁸⁶. Ftesa u dorëzohet të gjitha personave të cilët në një mënyrë apo tjetër kanë interes për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjerit. Sipas Ligjit për procedurë jokontestimore dhe Ligjit për procedurë kontestimore në ftesë duhet të shënohen të gjitha të dhënat e personit të ftuar në procedurë (trashëgimlënësit), të dhënat lidhur me adresën e zyrës të noterit si dhe dita dhe koha e mbajtjes së seancës. Noteri në ftesën për seancë sipas nenit 167 të Ligjit për procedurë jokontestimore është i obliguar që t'ua potencoj të ftuarve resp. trashëgimtarëve që në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë para vdekjes resp. ka përpiluar testament, t'a dorëzojnë të njëjtën në formë të shkruar, resp. ta dorëzojnë dokumentin në të cilën është regjistruar testamenti gojor ose t'i lajmërojnë dëshmitarët e testamentit gojor. Noteri në ftesën për pjesmarje në seancë do t'i njoftoj pjesmarësit procedural që deri në përfundimin e procedurës mundet të japin deklaratë lidhur me pranimin resp. heqjen dorë nga marja pjesë në ndarjen e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit.

1.3 Ndërprerja e procedurës të shqyrtimit të pasurisë trashëgimore

Ky veprim i noterit ka për qëllim të ndal procedurën dhe do t'i udhëzoj pjesmarësit në procedurë kontestimore apo administrative atëherë kur ndërmjet subjekteve procedurale paraqitet çfarëdo lloj kontesti për të drejtat të tyre të cilët të drejta dalin nga shqyrtimi i masës trashëgimore të trashëgimlënësit (al. 1 neni 173). Si fakte të tilla konsiderohen: fakte të cilët kanë të bëjnë me të drejtën trashëgimore resp. ato fakte nga të cilat varet e drejta në trashëgimi, fakte të cilët prekin plotfuqishmërinë e testamentit apo përmbajtjen e tij, pra validitetit i testamentit, fakte të cilët i vejnë në ndonjë dyshim mardhënien e trashëgimtarëve me trashëgimlënësin por vetëm kur si bazë për thirrje në trashëgimi paraqitet ligji, faktet të cilët paraqiten me rastin e paraqitjes të kërkesës për ndarje nga masa trashëgimore e trashëgimlënësit, sendet të cilët i kanë për përdorim të përditshëm në punët shtëpiake, e cila kërkesë paraqitet nga personat resp. nga bashkëshorti/ja e trashëgimlënësit të cilët me të kanë jetuar në bashkësi, fakte të cilët kanë të bëjnë me madhësinë e pjesës trashëgimore resp. me vlerën e saj, fakte të cilët kanë për qëllim të tregojnë padenjësinë e trashëgimtarit për të qenë trashëgimtar me rastin e ndarjes të trashëgimisë dhe fakte të cilët tregojnë heqjen dorë të një apo më shumë trashëgimtarëve nga trashëgimia.

Përveç rasteve të cilat i kam përmendur më lartë, Ligji për procedurë jokontestimore parasheh edhe dy raste kur noteri e ndërpret procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë dhe i udhëzon palët të nisin procedurë kontestimore resp. administrative edhe pse nuk egziston asnjë kontest lidhur me të drejtat apo faktet. Këto raste janë: kur ndërmjet trashëgimtarëve egziston kontesti për atë se prona e caktuar a duhet të bëj pjesë në trashëgimin e trashëgimlënësit dhe kur ndërmjet trashëgimtarëve paraqitet kontesti lidhur me kërkesat e personave të cilët persona kanë jetuar në bashkësi me trashëgimlënësin, të cilat kërkesa kanë të bëjnë me dhënien e një pjese të trashëgimisë të trashëgimlënësit e cila pjesë i përgjigjet kontributit të tyre në rritjen e vlerës së pronës të trashëgimlënësit.

1.4 Aktvendimi për shpalljen e trashëgimtarëve

Pas mbajtjes të seancës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, në atë rast me marjen e deklaratave të trashëgimtarëve si dhe " në bazë të rezultateve të procedurës të shqyrtimit të pasurisë trashëgimore "³⁸⁷ noteri është i obliguar që me anë të aktvendimit të përfundoj procedurën e tillë, resp. të vendos për pasurinë trashëgimore. Me anë të këtij aktvendimi, noteri përfundimisht i konstaton dhe i cakton trashëgimtarët e trashëgimlënësit të cilët kanë të drejtë të trashëgojnë pasurinë e tij (neni 177). Me Ligjin për procedurë jokontestimore janë përcaktuar saktësisht të dhënat (përmbajtja) e aktvendimit për trashëgimi.³⁸⁸ Në fillim aktvendimi përmban të dhënat për trashëgimlënësin siç janë: emri dhe mbiemri, emri i babait (për gratë e martuara mbiemri i vajzërisë), profesioni, data dhe vendi i lindjes, shtetësia dhe numri amzë. Në vazhdim aktvendimi për trashëgimtarët përmban edhe të dhënat të cilët janë të nevojshme për përcaktimin e madhësisë të pasurisë trashëgimore, të dhënat për trashëgimtarët të cilët me plotfuqishmërinë e këtij vendimi do të jenë titullar të të drejtave dhe obligimeve të cilët më parë kanë qenë të trashëgimlënësit, të dhënat e identifikimit të trashëgimtarëve siç janë: emri, mbiemri, emri i babait (mbiemri i

³⁸⁴ neni 153 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁸⁵ neni 167 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁸⁶ al. 2 neni 167 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁸⁷ Hamdi, Podvorica, E drejta trashëgimore, Prishtine, 2006, fq. 171

³⁸⁸ neni 177 Ligji për procedurë jokontestimore

vajzërisë kur kemi të bëjmë me gjininë femërore), vendi i banimit dhe numri amzë i tyre. Në këtë pjesë të aktvendimit do të shënohen edhe të gjitha të dhënat të cilët kanë të bëjnë me madhësinë (vlerën) e pjesës trashëgimore, mënyra e të trashëguarit (ligj - testament) si dhe mardhënia trashëgimtar - trashëgimlënës (bashkëshort/e, prind, fëmijë, të adoptuar, adoptues, etj).

Në aktvendim për trashëgimi gjithashtu do të përfshihen edhe të dhënat lidhur me të drejtat trashëgimore të trashëgimtarëve (fakti a shtyhet, kufizohet ose është shtyrë e drejta deri sa të plotësohet ndonjë kusht). Dhe në fund, në aktvendim gjithashtu do të shënohen edhe të dhënat të cilët kanë të bëjnë me legatët dhe personat e tretë të cilët kanë të drejtë të realizojnë ndonjë të drejtë nga pasurisa trashëgimore e trashëgimlënësit.

1.5 Kërkesat trashëgimore - juridike pas plotfuqishmërisë të aktvendimit për trashëgimi

Mund të ndodh që pasi që noteri të ketë shqyrtuar trashëgimin të paraqiten disa kërkesa juridiko - trashëgimore të cilat kërkesa kanë të bëjnë me paraqitjen e disa fakteve të reja në kuptimin subjektiv, pasi që si të tilla kan egzistuar në momentin e vdekjes por të cilat nuk i kan ditur apo nuk kan mundur t'i dinë trashëgimtarët, legatët dhe personat e tretë. Si fakte të tilla janë: *Gjetja e pronës së re* - sipas nenit 185, gjetja e pronës së re e cila nuk ka qenë e ditur me rastin e sjelljes të aktvendimit për trashëgimi, noteri si i besuar i gjykatës me aktvendim të ri dhe në bazë të aktvendimit të mëparshëm do të vendos edhe për atë pronë. Për pronën e re të gjetur do të vendos noteri në procedurën trashëgimore me kusht që ndërmjet trashëgimtarëve të mos ket asnjë lloj kontesti lidhur me pronën e re. Në të kundërtën për pronën e re të gjetur do të vendoset në procedurë konestimore nga gjykata kontesuese. Si fakt i dytë në bazë të paraqitjes së tyre paraqiten edhe kërkesat juridiko - trashëgimore të reja është edhe *gjetja e testamentit të ri* të trashëgimlënësit pas shqyrtimit të pasurisë trashëgimore me aktvendim të plotfuqishëm.³⁸⁹ Në rast të paraqitjes të testamentit të ri si " formë e vullnetit të fundit " të trashëgimlënësit paraqiten dy situata mjaft të rëndësishme: kur me aktvendim të plotfuqishëm për trashëgimi është shqyrtuar pasuria trashëgimore në bazë të ligjit dhe kur me aktvendim të plotfuqishëm për trashëgimi është shqyrtuar pasuria trashëgimore në bazë të testamentit të mëparshëm.

Si fakt i fundit, paraqitja e të cilës shkakton parashtrimin e kërkesës juridiko - trashëgimore është edhe *paraqitja e një personi të ri* si trashëgimtar i trashëgimlënësit i cili nuk ka mar pjesë në shqyrtimin e mëparshëm të pasurisë trashëgimore (neni 187). Ky person ka pasur cilsinë e trashëgimtarit, por për shkaqe të ndryshme nuk ka mar pjesë në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Në këto raste noteri është i obliguar që personin e tillë ta udhëzoj për nisje të procedurës kontestimore me paraqitje të aktpadisë në gjykatën kontestimore. Noteri do të vendos të ndërpres procedurën vetëm atëherë kur do t'i ketë mar deklaratat e të gjith pjesmarësve në procedurë. Sipas al.1 të nenit 176 të Ligjit për procedurë jokontestimore, noteri do ta udhëzoj në procedurë kontestimore resp. administrative atë pjesmarës, të drejtën e të cilit e llogarit si më të mundshme. Nëse pjesmarësi i udhëzuar në procedurë kontestimore apo administrative nuk nis procedurën brenda afatit të caktuar me aktvendim, ligji i jep të drejtën dhe mundësinë noterit që të vendos për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore me aktvendim të plotfuqishëm. Ndërsa në të gjitha rastet tjera ku pjesmarësi ka vepruar sipas udhëzimeve të dhëna nga ana e noterit në aktvendim, noteri është i obliguar që të pres dhe të mos mer asnjë veprim, deri sa procedura e nisur kontestimore resp. administrative nuk mbaron në mënyrë të plotfuqishme.³⁹⁰

PËRFUNDIM

Si përfundim të këtij punimi mund të theksoj se Republika e Maqedonisë jo vetëm në sferën politike por edhe në atë juridike, me qëllim të modernizimit të të njejtave i pranoj të gjitha sfidat dhe ndryshimet në bazë të parimeve të Unionit European të cilat parime kërkonin shkarkimin e gjyqsorit nga lëndët jokontestimore. Me vendosjen e notarijatit si institucion nga shumë shtete europiane, u rrit edhe efikasiteti i institucioneve si rezultat i zvogëlimit të trafikut juridik, edhe Republika e Maqedonisë i ndoqi hapat e atyre shteteve me ç'rast filloi shkarkimi i gjykatave nga lëndët jokontestimore si: përpilimi dhe vërtetimi i dokumenteve, vërtetimi i nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe përshkrimeve, depoziti gjyqësor, etj si edhe shqyrtimi i masës trashëgimore nga viti 2008. Normalisht ky shkarkim respektivisht dhënia e kompetencave për shqyrtimin e masës trashëgimore, u'a mundësoj qytetarëve zvogëlim të shpenzimeve si dhe sjelljen e vendimeve më të shpejta si dhe shumë më kualitative e cila do të mundësohet si rezultat i ndërmarjes të shpejt të veprimeve juridike nga ana e noterit pas pranimit të lëndës trashëgimore.

Edhe pse si qëllim kryesor për dhënien e kompetencave noterëve si të besuar të gjykatës në procedurën e shqyrtimit të masës trashëgimore është shkarkimi i gjykatave nga lëndët jokontestimore me këtë edhe të lëndëve trashëgimore,

³⁸⁹ neni 186 Ligji për procedurë jokontestimore

³⁹⁰ Јаневски.А , Зороска - Камилоска. Т, Граѓанско процесно право - Вонпарнично право, Скопје, 2010, стр. 138

nuk mundem të mos e përmend edhe faktin se përveç kësaj, shkak për dhënien e kompetencave noterëve në lëndët jokontestimore është edhe rritja e efikasitetit në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë e cila nënkupton zgjedhje të shpejtë dhe efikase të lëndëve kontestuese nga ana e gjykatave nga njëra anë dhe lëndëve jokontestimore të besuar noterëve nga ana tjetër, gjë që solli në përmirësimin e funksionimit të sistemit juridik në shtetin tonë. Se u arrit përsheptim i procedurës të shqyrtimit të masës trashëgimore me besimin e këtyre lëndëve noterëve lehtë konstatohet nga analiza e raporteve të punës së gjykatave deri në vitin 2008 e prej vitit 2008 e deri më sot të punës së noterëve si të besuar të gjykatës. Kohëzgjatja e procedurës nga dita e dorëzimit të lëndës e deri në ditën e plotfuqishmërisë të vendimit për trashëgimi u shkurtua në disa ditë, më saktë nga 5 ditë deri në 8 ditë e ndonjëherë deri në 15 ditë varësisht nga lënda si dhe interesimi i pjesmarësve në procedurë, përderisa deri në vitin 2008 kur kjo procedurë udhëhiqeshte nga ana e gjykatave trashëgimore, kohëzgjatja ishte dukshëm më i gjat dhe atë një deri në dy muaj varësisht nga natyra e lëndës.

Se dhënia e kompetencave noterëve u tregua si një zgjidhje e mirë, si indikator për këtë tregon kënaqësia e cila shihet tek qytetarët të cilët nëpërmjet të komunikimit personal dhe të thjeshtë me noterët, njoftohen për të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe kënaqësia e kryerjes të shpejtë të punës respektivisht të kryerjes të shpejtë të procedurës të shqyrtimit të masës trashëgimore.

BIBLIOGRAFIA

Brestovci, F, E drejta procedurale civile II, Prishtinë, 2004

Curi, P, E drejta procedurale civile & Noteria, Tiranë, 2008

Podvorica, H, E drejta trashëgimore, Prishtinë, 2006

Атиќ, А, Наследно право, Београд, 2008

Георгиевски, С, Коментар на законот за вонпроцесната постапка, Скопје, 1989

Јаневски, А, Зороска – Камилоска, Т, Вонпарнично право, Скопје, 2010

Спировиќ – Трпеновска, Ј, Мицковиќ, Д, Ристов, А, Наследното право во Република Македонија, Скопје, 2010

Тумановски, Д, Збирка прописи од области на нотариатот, Скопје, 1999

Ligjet

Ligji për gjykatat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/95

Закон за вонпарнична постапка, Службен весник на Република Македонија, бр. 9/2008

Закон за вонпроцесната постапка, Службен весник бр. 19/1979

Закон за наследство, Службен весник на Република Македонија, бр. 47/96

Закон за нотариат, Службен весник на Република Македонија, бр. 55/07, бр. 86/2008, бр. 39/2009

Burimet tjera

<http://en.wikipedia.org/wiki/Notary>

www.notaries.com

Јаневски, Арсен, Нотарската дејност во Р.М, Нотариус, бр. 1, Нотарска комора на Р.М, Скопје, 2001, стр. 24 - 37

Јаневски, Арсен, Потреба од растоварување на судовите од неспорни работи, Нотариус, бр.12, Нотарска комора на Р.М, Скопје, 2009, стр. 30 – 41

Кочов, Божидар, Расправање на оставината според Законот за вонпарничната постапка, Правник – стручно издание, бр. 204, Здружение на правници во Р.М, Скопје, 2009, стр. 44 – 47

Николовски, Златко, Правна положба на нотарот како повереник во оставинската постапка, Нотариус, бр. 11, Нотарска комора на Р.М, Скопје, 2009, стр. 5 – 12

Стоев, Фиданчо, Положба и овластувања на нотарот како повереник на судот во оставинската постапка, Нотариус, бр. 11, Нотарска Комора на Р.М, Скопје, 2009, стр. 12 – 18

Чесноска – Танева Стефка, Нотарите како повереници на судот, публикација Правник. ISSN 1409 – 5238 , Год. 18, бр.206 (јуни 2009), стр. 55 - 56